

## PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Mirembajtje rruge e trotuare ne Qytet”(shtese)

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 50000000-5-Shërbime mirëmbajtje dhe riparimi

VLERA E FONDIT LIMIT: **2,814,838** leke pa tvsh (Dy milion e teteqind e katermbedhjte mije e teteqind e tridhjte e tete)

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Shkodër** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**”Mirembajtje rruge e trotuare ne Qytet “(rialokim)**

#### **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:
  - a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9
  - b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin76 ”Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari permbledhes i vetdeklarimit” dhe Neni 83 ”Sigurimi i ofertes”, te Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe ne mbeshtetje te Nenit 26 ”Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i LPP “1. *Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik”.*

Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”,

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

*Me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik sipas Shtojcës 9.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019,2020,2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlogaritur e fondit limit të kontratës e konkretisht **2,814,838** (Dy milion e teteqind e katermbedhete mije e teteqind e tridhjetë e tete) leke pa tvsh.*Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

### **Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”” *Ne lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetit ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë që operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën”,*”*Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, si dhe bazuar në nenin 43, pika 2/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:b) vlerën e përlogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatorit ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Duke marrë në konsideratë se Lloji i procedure është "Sherbim" Procedure e Hapur", vlerën e fondit limit të kësaj procedure prokurimi (Lotit), kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **2,814,838** (Dy milion e teteqind e katërmbëdhjetë mijë e teteqind e tridhjetë e tete) leke pa tvsh që është vlera e fondit limit dhe vendosja e këtij limiti nuk kufizon pjesëmarrjen e operatoreve ekonomike.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në mbështetje të nenin 43, pika 1 " të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ku përcaktohet se: " Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare", Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarinimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore": "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji."

**2.2.2.** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020, 2021 dhe 2022, të certifikuar nga autoritetet përkatëse (Dega e Tatim Taksave) ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat

tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

**2.2.3** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitet për vitin 2021 (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2021.

**2.2.4** *Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT.*

*Dokumenti i kërkuar më sipër do të paraqitet përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenin 41, pika 5/ c), pika 6, nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku ndër të tjera përcaktohet: *Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.* si dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

Meqenese operatorët ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrorjnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe konkretisht **562,968 (pesëqind e gjashtëdhjetë e dymijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë.**

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontratën e nënshkruar me entin, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Enti

Publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit të kontratës.

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 "Kërkesat për kualifikim", të Ligjit Nr 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" pika 4. *ne lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerezore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në vecanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontrata e zbatuara në të shkuarën si dhe në nenin 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit të lotit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e ulët monetar, vlera për shërbime të ngjashme prej **1,125,935** (Një milion e njëqind e njëzet e pesë mijë e nentëqind e tridhjetë e pesë) leke përbën një nivel të mjaftueshëm përvojë duke patur parasysh objektin dhe vlerën e kontratës dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Vlera e kërkuar nuk sjell kufizim të konkurrencës dhe është në masën 40% të fondit limit të lotit

**2.3.2** Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me licencë profesionale sipas modelit të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e cila të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

**Punime të përgjithshme ndërtimi:**

Kategoria NP-1 Niveli A “Punime germimi”

Kategoria NP-4 Niveli A “Rruge ,autostrada,mbikalime..”

Kategoria NP-7 Niveli A “Ujesjellesa, gazsjellesa, vajsjellesa,...”

**Punime speciale ndertimi**

Kategoria NS-1 Niveli A “Punime per prishjen e ndertimeve..”

*Argumentimi:* Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.01.2008, "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", i ndryshuar.

Përcaktimi i kategorisë së licencave bazohet në kriteret të përcaktuara ligjore e teknike. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.." Lidhur me nivelin e kategorive në licencë janë në përputhje me natyrën dhe fondin limit që prokurohet, si dhe kërkohet që operatorët ekonomik të japin garanci që i kanë aftësitë tekniko profesionale ne nivele të kategorive për realizimin e objektit që prokurohet.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Licencat janë të lidhura ngushtësisht me zërat e punimeve te ndërtimit. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret, që autoriteti i vlerëson të nevojshme, për sa kohë ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

**Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:**

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
<u>Kategoria NP-1</u>	Punime germimi	Zeri nr 4,5	Niveli A	60,192
<u>Kategoria NP-4</u>	Rruge ,autostrada,mbikalime	zeri nr 6,7,8,9,10,11,13,14,15	Niveli A	2,455,998
<u>Kategoria NP-7</u>	Ujesjellesa ,gazsjellesa,vajsjellesa	zeri nr 12	Niveli A	25,610
<u>Kategoria NS-1</u>	Punime per prishjen e ndertimeve	zeri nr 1,2,3	Niveli A	273,038

**2.3.3** Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt te pakten:

1 (një) inxhinier ndertimi

Inxhinieri i mësipërm duhet të jetë i siguruar dhe të figurojë me kohë të plotë në listëpagesat perkatase E-Sig për të paktën **muajin e fundit**.

Lidhur me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Kontratën individuale të punës,Diplomën e inxhinierit të mësipërm.

*Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”,*”Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”* dhe nenit 41, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”” si dhe ligjin 8402 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” date 10.09.1998 i ndryshuar

Eshtë kërkuar inxhinier ndertimi për zbatimin e punimeve ne perputhje me zerat e punimeve te preventivit ,projektit, specifikimeve teknike që do te zbatohen dhe si dhe kategorive perkatase

ne licencen perkatese te zbatimit, Inxhinieri ndertimit është përgjegjës për zbatimin e saktë të projektit për secilin nga zërat e punimeve. Ai është përgjegjës për cilësinë e materialeve që vendosen në objekt

**2.3.4** Vetedeklarimin nga inxhinieri I ndertimit se ai është i disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është bazuar në [Rekomandimin Nr. 6732 date 21.10.2020](#) "Mbi Problematikat e konstatuara gjatë monitorimit nga APP"

**2.3.5** Operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) duhet të përcaktojë **Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt**, i cili duhet të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë, të figurojë i punësuar me kohe të plote në listepagesa.

Bashkëlidhur deklaratës për Drejtuesin Teknik duhet të paraqitet; a) CV, b) Kontratën e punës dhe c) Diplomën.

*Kriteri konsiderohet i permbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 41, pika 4, gërma b) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Eshtë vendosur ky kriter duke u bazuar në ligjin 8402 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndertimit" date 10.09.1998 i ndryshuar, pasi për çdo objekt zbatimi duhet të ketë drejtuesin e saj teknik i cili ushtron detyrat e tij në përputhje me këtë ligj dhe vendim Nr.312, datë 5.5.2010 "Për miratimin e rregullores "për sigurinë në kantier"

**2.3.6** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve për realizimin dhe zbatimin e kontratës. Numri mesatar i punonjësve të siguruar për **muajin e fundit** duhet të jetë **5 (pesë)**.

Lidhur me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë vertetimin të lëshuar nga Dega e Tatimit Taksave ose Dega e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetsore në të cilin të jetë i përcaktuar numri i punonjësve të siguruar për periudhën e mësipërme, shoqëruar me listepagesat përkatëse E-Sig, për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore.

*Kriteri konsiderohet i permbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenin 41, pika 4, gërma c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të



prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Prandaj në lidhje me përcaktimin e numrit të punonjësve është përdorur edhe eksperiencia e mëparshme ndër vite duke qenë se edhe nga eksperiencia e të gjitha këtyre viteve ka rezultuar e sukseshme dhe i mjaftueshëm një numër i tillë punëtorësh për të realizuar shërbimin e mirëmbajtjes

Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur si më poshtë:

Numri i punonjësve 5 (pese)

Afati 2 (dy) muaj

Sasia e orëve të punës sipas manualit sipas zerave të punimeve është  $837:8=105:44=2.37$  punonjës

Nevojitet 1- teknik ndertimi për ndjekjen e punimeve në objekt, organizimin e punës etj  
1-shoferë  
1-manovrator

**Totali 5 punonjës**

Në lidhje me vërtetimin të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve kjo kërkesë është e mbështetur në Nenin 41, pika 6 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" sipas së cilës: "Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurrohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës".

**2.3.7** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës të pasqyruar në listëpagesa për të paktën **muajin e fundit**, të paisur me kontratë pune (të vlefshme), ose të kontraktuar në rastin kur makineritë janë me qera për manovratorët me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik (të vlefshme) të lëshuara nga organizma të akredituar për këtë qëllim në Republikën e Shqipërisë, ku nga këta të jenë të paktën:

Teknik ndertimi	1 (një) punonjës
Muratori	2 (dy) punonjës
Manovrator	1 (një) punonjës
Punonjës asfalti	1 (një) punonjës

Manovratori duhet të jetë punonjës i specializuar për drejtimin e mjeteve të rënda (Eskavatorist) dhe për këtë duhet të paraqesin dëshmi nga Drejtoria e Shërbimit të Transportit Rrugor ndërsa për teknikun e ndertimit duhet të paraqitet diploma e shkolles/dëshmi nga organe/institute të akredituar.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ c), pika 6 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

1(nje)murator nevojitet per kryerjen e punimeve te ndertimit, sasia e oreve te punes sipas manuali eshte  $560:8=70:44=1.59$  punonjes

1(nje) punonjes asfalti nevojitet per kryerjen e punimeve te asfaltimit.Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte: $125:8=15,62:44=0.35$  punonjes

Vendosja e ketyre kriterëve për fuqinë punëtore është bërë në përputhje me zerat dhe vëllimet e preventivit, me afatin e zbatimit të punimeve sipas grafikut të punimeve, që është perlllogaritur si dhe mjeteve të kërkuara për zbatimin me sukses të kësaj kontrate.

Kërkesa që punonjësit të jenë me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik (te vlefshme) të leshuara nga organizma të akredituar për këtë qëllim në Republikën e Shqipërisë është bërë bazuar duke vlerësuar se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për sigurimin e jetës dhe shëndetit të punëmarrësve nëpërmjet zbatimit të masave të nevojshme sipas dispozitave të ligjit nr.8734, datë 1.2.2001 për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike” i ndryshuar

Kërkesa për dëshmitë e manovratorëve bazohet në Urdhërin e Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 200, datë 16.5.2019 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi I përdorimit të makinerive të ndërtimit”

**2.3.8** Ofertuesi duhet të disponojë minimalisht mjetet e mëposhtme për kryerjen e punimeve, me qëllim realizimin e objektit të prokurimit :

<i>Nr</i>	<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>
1	<i>Mjet transporti vetshkarkues 10 tone(ngarkesa)</i>	<i>1 cope</i>
2	<i>Mjet transporti vetshkarkues deri me 5 tone(ngarkesa)</i>	<i>1 cope</i>
3	<i>Eskavator me goma</i>	<i>1 cope</i>
4	<i>Grejder</i>	<i>1 cope</i>
5	<i>Rrul</i>	<i>1 cope</i>
6	<i>Autobot</i>	<i>1 cope</i>

7	<i>Prerese asfalti</i>	<i>1 cope</i>
8	<i>Autobitumatrice</i>	<i>1 cope</i>
9	<i>Asfaltoshtruese</i>	<i>1 cope</i>
10	<i>Matrapik</i>	<i>1 cope</i>
11	<i>Betoniere</i>	<i>1 cope</i>

**Si deshmi per plotesimin e kesaj pike Operatori duhet te paraqese:**

- i. Për mjetet në pronësi që shënohen në regjistra publikë, të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe çertifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme).
- ii. Për mjetet që nuk shënohen ne regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre: aktet e zhdoganimit ne Republikën e Shqiperisë ose faturat tatimore te blerjes.
- iii. Për te gjitha mjetet e marra me qira, të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet afati i kontratës.
- iv. Per mjetet e marra me qera qe shenohen ne rregjistra publik, duhet te paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe çertifikata për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Kurse per mjetet që nuk shënohen ne regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre, aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.

*Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkojnë sqarime nga autoriteti kontraktor.*

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**Mjet transporti vetshkarkues 10ton(ngarkesa)**

Transport dhera  $m^3 177 * 1.6 = 283$  ton

Transport cakell rere e zhavor stabilizant  $96m^3 * 1.8 = 173$  ton

Transport A/B – 110 ton

Transport materiale te ndryshme 20 ton

Totali  $586 \text{ ton} : 44 = 13.3 \text{ ton}$  ,mesatarisht 2 rruge ne dite

Mjeti I transportit deri 5 ton nevojitet per transportin e materialeve te ndertimi si cemento tuba etj

Eskavator me goma nevojitet per germim dhe ,grumbullim me shkarkim ne mjet zeri nr 4 .

Grejderi nevojitet per nivelimin e shtreses se stabilizantit ne preventive zeri nr 7 .

Rruli nevojitet per ngjeshjen e shtreses se çakellit dhe stabilizantit dhe A/B ne preventive zeri nr 6,7,8,9.

Autoboti nevojitet per lagien para ngjeshjes te shtreses se çakellit dhe stabilizantit ,ne preventive zeri nr 6,7.

Autobitumetricja nevojitet per lagien me bitum te shtreses se stabilizantit ne preventive zeri 7

Asfaltoshtuesja nevojitet per hapjen ne rruge te shtreses se A/B ne preventive zeri nr 8,9

Prerese asfalti nevojitet per prerjen e shtreses asfaltike ne pjeset e rruges ku do te kryhet riparimi.Ne preventive zeri nr 1.

Matrapiku nevojitet per prishjen e strukturave prej betoni,ne preventive zeri nr 3.

*V.O Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare (pika 2.2.1, të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike (pikat 2.3.6 dhe 2.3.8 të seksionit 2.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në këtë rast, operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të paraqesë një deklaratë ku të listohen dokumentet e paraqitura në përmbushje të kriterëve kumulative për Lotin konkret. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotëson kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të skualifikohet nga të gjitha Lotet ku ka ofertuar.*

*Eshte vendosur ky kriter duke patur parasysh shperndarjen gjeografike te akseve te rrugeve ku do realizohet sherbimi I mirembajtjes se rrugeve .*

*ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik”.*

*Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”,*